



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë
Ministarstva Pravde
Ministry of Justice

Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës Ndaj Grave

Ky dokument është hartuar me mbështetjen financiare të projektit "Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit", zbatuar nga Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund të pasqyrojnë mendimin zyrtar të Këshillit të Evropës.



Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i Programit

Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave (tutje Programi) është një iniciativë e ndërtuar mbi parimet e ndërhyrjes strategjike dhe rehabilitimit psiko-social për ata që kanë kryer dhunë ndaj partneres grua.

Programi ka për qëllim të ndryshojë sjelljet e dhunshme të kryerësve nëpërmjet një rrugëtimi transformues që çon drejt adoptimit të sjelljeve jo të dhunshme dhe të respektueshme në marrëdhëniet ndërpersonale.

Edhe pse theksi i Programit është reformimi dhe rehabilitimi i kryerësve, në thelb, synimi përfundimtar qëndron në krijimin e një mjedisi të sigurt për të mbijetuarat, ofrimi i mbështetjes dhe sigurisë se nevojshme për t'u fuqizuar dhe ecur përpara.

Programi është në harmoni të plotë me "Kurrikulën për trajnimin e profesionistëve për ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës në familje në Republikën e Kosovës" dhe "Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026". Programi, gjithashtu, është në përputhje me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (e njohur gjithashtu si Konventa e Stambollit).

Programi bazohet në modelin "Duluth të fuqisë dhe kontrollit" dhe bazohet në përzierje të metodave psiko-edukative të integruara në një seri sesionesh të strukturuar. Ky model synon të adresojë faktorët psikologjikë që kontribuojnë në sjellje abuzive. Programi fillon me fazën e vlerësimit përmes sesioneve individuale dhe vijon me sesione grupore të ndërtuara mbi njëra-tjetrën deri në përfundimin e Programit.

Modeli Duluth vë në pah ndikimin e normave shoqërore dhe veçanërisht ato që lidhen me gjininë. Modeli vë në dukje se dhuna në familje pasqyron dhe forcon strukturat patriarkale, të cilat presin që burrat të ushtrjnë kontrollë mbi partneret e tyre.

"Programi bazohet në modelin Duluth të fuqisë së kontrollit"

Në këtë prizëm, dhuna nuk shfaqet si një veprim i izoluar, apo i veçuar individualisht, por si manifestim i një kushtëzimi shoqëror të thellë. Ky model argumenton që motivimi i dhunuesit për të ushtruar dhunë në familje lidhet drejtpërdrejt me dëshirën për të qenë në pozitë kontrolli dhe jo si rezultat i çrregullimeve të patologjisë individuale. Modeli kornizon dhunën në familje si një zgjedhje të qëllimshme të nxitur nga dëshira për dominim.

Ky interpretim thekson se dhuna në familje nuk duhet të konsiderohet vetëm si një sërë incidentesh të izoluar, por si një pjesë e një sistemi më të gjerë që është i ndërthurur me besimet dhe strukturat e shoqërisë. Prandaj, qasja jonë ndaj ndërhyrjes synon të ndikojë jo vetëm në sjelljen individuale, por edhe në transformimin e besimeve dhe normave shoqërore që kontribuojnë në ekzistencën dhe vazhdimin e dhunës në familje.

Qasja e Programit

Qasja psiko-edukative, që është në qendër të këtij Programi, është kritike për të ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë dinamikën e dhunës në familje, pasojat e saj sociale dhe ligjore, dhe nevojën thelbësore për ndryshim të sjelljes. Ky Program ngritë vetëdijen mbi efektin e sjelljes abuzive tek të mbijetuarat dhe ndikimin që ajo ka në familje dhe shoqëri në tërësi.

Pjesëmarrësit do të përfitojnë nga aktivitetet praktike dhe edukative që i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të menaxhuar stresin, për të komunikuar efektivisht dhe për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme. Këto aktivitete përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në, ushtrime për të rritur vetëbesimin, zgjidhjen e konflikteve në mënyrë jo të dhunshme dhe ndërtimin e empatisë.

Struktura e programit të ndërhyrjes për kryerësit të dhunës përmban një qasje gjithëpërfshirëse, duke filluar me një vlerësim të detajuar, të ndjekur nga puna në grupe të synuara dhe duke përfunduar me një strategji daljeje të planifikuar me kujdes. Kuptimi i këtij procesi në tërësinë e tij i lejon lehtësuesit/es të shohin se si secila fazë ndërtohet mbi tjetrën, duke krijuar një rrugë gjithëpërfshirëse dhe koherente drejt ndryshimit pozitiv.

Duke u zhytur në secilën fazë me këtë perspektivë gjithëpërfshirëse, lehtësuesit/et mund të përshtatin në mënyrë më efektive qasjet e tyre nevojave individuale të pjesëmarrësve, duke rritur suksesin e programit në reduktimin e dhunës në familje.

Profesionistët që e ofrojnë Programin

Programi synon të arrijë një ndryshim të përhershëm në sjelljen e kryerësve të dhunës dhe të ndërtoj marrëdhënie të shëndosha ndërpersonale. Profesionistët nga fusha të ndryshme: përfshirë psikologë, psikiatër, punonjës socialë, zyrtarë korrektues, zyrtarë të shërbimeve sprovuese, avokatë dhe aktivistë, mund të jenë lehtësues/e të këtij programi. Kohëzgjatja e trajnimit për lehtësuesit/et është 7 deri në 14 ditë, me trajnime të vazhdueshme profesionale. Lehtësuesit/et e Programit do të jenë të trajnuar dhe të certifikuar për të zbatuar udhëzuesit gjithëpërfshirës që përmbajnë metodologji dhe teknika të avancuara për ofrimin e shërbimit.

Udhëzuesit përfshijnë hapat e mëposhtëm:

Vlerësimi i përputhshmërisë së kryerësit të dhunës për ndjekjen e programit.

Vendosja e marrëdhënieve të besimit ndërmjet kryerësit dhe lehtësuesit/es.

Bashkëpunimi me shërbimet mbështetëse për viktimat.

Zbatimi dhe menaxhimi efektiv i çdo hapi të ndërhyrjes.

Vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programit.

Plani i daljes për të siguruar një tranzicion të qëndrueshëm dhe suksesin afatgjatë.

Në zbatimin e Programit, një vëmendje të veçantë i kushtohet vetëdijësimit për rreziqet e mundshme, siç janë shpresat potencialisht të rreme të të mbijetuarve për ndryshim dhe mundësia që kryerësit të manipulojnë programin në avantazhin e tyre.

Ky aspekt diskutohet në detaje me pjesëmarrësit dhe gjithashtu monitorohet nga lehtësuesit/et për të siguruar që Programi ofron një ndërhyrje të shëndetshme dhe të sigurt.



Struktura e Programit

Programi është një intervenim i strukturuar gjashtë mujor i cili përmban 24 seanca grupore dy orëshe, të cilat janë të ndërtuara mbi një bazë modulare për të adresuar aspekte të ndryshme të sjelljes dhe mentalitetit të kryerësve të dhunës.

Çdo modul është i bazuar në metodologji dhe praktika të njohura ndërkombëtarisht që janë të dëshmuara për efektivitetin e tyre në ndryshimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të përfshirë në dhunë.

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore, pjesëmarrësit do të udhëhiqen nëpërmjet një sërë sesionesh të cilat synojnë të stimulojnë reflektim dhe të nxisin një transformim pozitiv në sjelljet dhe mënyrat e të menduarit. Secili modul trajton një temë specifike dhe kontribuon në zhvillimin e një sjellje më pozitive dhe jo të dhunshme.



“Programi është një intervenim i strukturuar gjashtë mujor i cili përmban 24 seanca grupore 2 orëshe”

MODULI 1

Teknikat e de-eskalimit - Përfshinë strategji të menaxhimit të zemërimit dhe teknika për të ulur tensionin në situata konflikti.

MODULI 2

Qëndrimet ndaj grave - Analiza e roleve gjinore dhe të kuptuarit e ndikimit të stereotipeve dhe paragjykimeve në sjelljen dhunuese.

MODULI 3

Të kuptuarit e ciklit të dhunës dhe abuzimit - Njohja e dinamikave të dhunës në familje dhe ndërgjegjësimi i ciklit abuziv.

MODULI 4

Marrëdhëniet me respekt - Ndërtimi i një kuptimi të marrëdhënieve të shëndetshme dhe të përgjegjshme.

MODULI 5

Abuzimi emocional - Njohja e formave të abuzimit emocional dhe mënyrat për të parandaluar sjelljet manipulative dhe kontrolluese.

MODULI 6

Respekti seksual - Edukimi mbi konsentin (pëlqimin) dhe rëndësinë e respektit në marrëdhëniet intime.

MODULI 7

Ndërtimi i empatisë/dhembshurisë - Zhvillimi i aftësisë për të ndjerë dhe shprehur ndjenjat në një mënyrë konstruktive dhe jo të dhunshme.

MODULI 8

Të kuptuarit e efekteve tek fëmijët - Sensibilizimi mbi ndikimin e dhunës në zhvillimin emocional dhe psikologjik të fëmijëve.

MODULI 9

Shqyrtimi i sjelljeve abuzive në të kaluarën dhe aktuale - Reflektimi dhe përpunimi i sjelljeve të mëparshme dhe zotimi për ndryshim.

MODULI 10

Prindërimi - Nxitja e praktikave të prindërimit pozitiv dhe përgjegjës për të ndikuar në brezin e ardhshëm.

Secila nga këto seanca dhe module janë të projektuara për të punuar në mënyrë sinergjike me njëra-tjetrën për të ofruar një qasje të plotë dhe të gjithanshme ndaj ndryshimit të sjelljeve të dhunshme dhe për të ndihmuar në parandalimin e përsëritjes së dhunës në familje dhe shoqëri.

Përmbyllja e Programit nuk do të thotë thjesht përfundim i një serie sesionesh, por fillimi i një kapitulli të ri për pjesëmarrësit, të pajisur me njohuri dhe aftësi të reja për të vepruar nëpër kompleksitetin e marrëdhënieve ndërpersonale pa përdorur dhunë.

Suksesi i Programit matet jo vetëm në sjelljet e ndryshuara dhe reduktimin e recidivizmit, por edhe në lirinë e të mbijetuarave për të ndërtuar një jetë pa frikë dhe në empatinë e rritur dhe mirëkuptimin që pjesëmarrësit tregojnë në të gjitha marrëdhëniet e tyre.

Ky qëllim kaq thelbësor e bën programin jo thjesht një ndërhyrje, por një udhëzues ndryshimi transformues për individët dhe, në mënyrë më të gjerë, për shoqërinë.